

UDHËZIM
Nr. 324, datë 2.10.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, PROCEDURAVE PËR ADMINISTRIMIN
E TË ARDHURAVE DHE LIMITEVE TË KRYERJES SË SHPENZIMEVE PËR
PASURITË E SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 5, të nenit 30, si dhe të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. TË ARDHURAT NGA ADMINISTRIMI I PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfiton të ardhura nga:

- a) dhënia me qira e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;
- b) interesat bankare të depozitave të siguruara;
- c) pasuritë e konfiskuara (llogari bankare);
- ç) shitja e pasurive të konfiskuara;
- d) të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme të sekuestruara, të cilat me kalimin e kohës prishen, dalin jashtë përdorimit apo u bie vlera në mënyrë të ndjeshme dhe është marrë vendim nga Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar për shitjen e tyre;
- dh) të ardhura të tjera të siguruara nga burime të ligjshme;
- e) të ardhura nga buxheti i shtetit.

2. Të ardhurat nga pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara sipas pikës 1, të këtij udhëzimi, depozitohen në një llogari rrjedhëse me emërtimin “Të ardhura e shpenzime për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara në administrim të AAPSK”, të çelur nga Agjencia në një bankë të nivelit të dytë, me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

3. Të ardhurat nga interesat bankare gjenerohen në depozitë duke shtuar vlerën e tyre fillestare nga momenti i sekuestrimit ose konfiskimit pasurive.

4. Të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara sipas pikës 2, të këtij kreu, përdoren nga AAPSK-ja, vetëm për qëllime të shpenzimeve për këto pasuri. Të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, nuk mund të përdoren për paga, apo shpërblime të personelit të brendshëm të Agjencisë.

5. Në fund të çdo viti financiar, në varësi të nevojave të Agjencisë, Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar mund të vendosë që një sasi e të ardhurave të siguruara nga administrimi i pasurive të kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

II. SHPENZIMET E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE

1. Shpenzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara janë shpenzime të cilat kryhen gjatë kohës që këto pasuri janë në administrim të Agjencisë.

2. Shpenzimet që kryen Agjencia gjatë administrimit të pasurisë, janë:

2.1 Shpenzimet për marrjen në dorëzim dhe administrim të pasurisë. Këto shpenzime përbëhen nga:

a) shpenzimet për udhëtimin dhe dietat të personelit të ngarkuar nga Agjencia për marrjen në administrim të pasurive;

b) shpenzimet për pagesat e pajisjeve treguese, ndërrimin e bravave (dryna, kyçe etj.), çmontimeve, montimeve, transportit të ngarkesave të mallrave/pajisjeve, shërbime karrotreci, shërbime te magazinimit dhe të mirëmbajtjes së objektit;

c) shpenzimet për komisione bankare.

2.2 Shpenzimet për ruajtjen fizike apo digjitale (kamera sigurie) të pasurive.

2.3 Shpenzimet e sigurimit të pasurisë, sipas policave të sigurimit të ofruar nga kompanitë e sigurimit në bazë të legjislacionit në fuqi mbi sigurimin e pasurisë. Sigurimi i pasurisë bëhet për çdo njësi pasurie. Për pasuritë e paluajtshme, vlera për t'u siguruar do të jetë jo më e vogël se vlera e referencës së dhënë në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

2.4 Shpenzimet e mirëmbajtjes ruajtjen e pasurisë nga shkatërrimi, dëmtimi apo faktorë të tjerë dhe që kushtëzohen nga ruajtja e gjendjes fizike të pasurisë ashtu siç është marrë në dorëzim.

2.5 Shpenzimet për marrjen e ambienteve me qira për magazinimin e pasurive të luajtshme të sekuestruara/konfiskuara, me qëllim sigurimin dhe magazinimin e tyre, deri në ndryshimin e destinacionit përfundimtar.

2.6 Shpenzime për mundësimin e kryerjes së veprimtarisë ekonomike në ato pasuri, të cilat mund të gjenerojnë të ardhura dhe konkretisht:

a) shpenzimet për instalime dhe riparime të domosdoshme;

b) shpenzimet për botimin e njoftimeve të qirasë, njoftimeve të shitjes, kërkesave për shprehje interesi, njoftimeve të tjera mbi pasurinë;

c) shpenzimet për mbikëqyrjen dhe kontrollin administrativ të aktivitetit të këtyre pasurive, ku përfshihen udhëtime e dieta, kancelari e pajisje të tjera komunikimi;

d) shpenzimet për pagesat e detyrimeve fiskale në ngarkim të pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi (shpenzimet për pagesën e taksave vendore);

e) shpenzimet për pagesat e energjisë, ujit.

2.7 Shpenzimet për pagesën e administratorit të pasurisë dhe të personelit ndihmës, të cilat janë:

a) paga e administratorit të pasurisë dhe e personelit ndihmës të kontraktuar nga AAPSK-ja;

b) shpenzimet e kryera nga administratori i pasurisë, dhe ndihmës administratori, të cilat mund të përfshijnë, udhëtime e dieta dhe shpenzime të tjera administrative.

2.8 Shpenzimet për pagesën e shërbimeve të ekspertizës dhe këshillimit teknik përbëhen nga:

a) pagesat për ekspertët e vlerësimit të pronave dhe ekspertët kontabël;

b) pagesat për konsulencë tekniko-ekonomike.

3. Kërkesa për kryerjen e shpenzimeve të pasurisë miratohet nga kryeadministratori.

4. Formulari i kërkesës për kryerjen e shpenzimeve të pasurisë është sipas formatit në aneksin 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

5. Limitet për procedurat e kryerjes së shpenzimeve janë ato të përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi prokurimin publik.

III. RREGULLAT PËR MËNYRËN DHE MBAJTJEN DHE EVIDENTIMIN E SHPENZIMEVE TË TË ARDHURAVE.

1. Të gjitha shpenzimet e përmendura në kreun e III-të të këtij udhëzimi, do të përballohen nga të ardhurat e depozituara nga Agjencia në llogarinë "Të ardhura e shpenzime për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara në administrim të AAPSK-së".

2. Kur të ardhurat e siguruar nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e përmendura në kreun III, atëherë shpenzimet përballohen nga buxheti i shtetit.

3. Për çdo pasuri mbahet në mënyrë analitike kartela, ku evidentohen të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj pasurie. Kartela mbahet nga administratori i pasurisë dhe raportohet në Agjenci sipas kërkesës së kryeadministratorit. Forma e kësaj karteje është sipas aneksit nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Agjencia mban në bilancin e saj shifrat e miratuara në planin e buxhetit të miratuara nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

5. Të ardhurat dhe shpenzimet për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara evidentohen dhe mbahen jashtë bilancit të Agjencisë dhe raportohen sipas planit të raportimit të miratuar në planin vjetor të punës dhe buxhetit.

6. Vlerat monetare të sekuestruara/konfiskuara *cash* ose në numra llogarie të subjekteve do të mbahen dhe evidentohen jashtë bilancit të Agjencisë.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Aktiviteti i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është subjekt i auditimit të Drejtorisë së Auditimit të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

2. Udhëzimi nr. 27, datë 23.9.2008 “Për procedurat dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve, rregullat për mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, rregullat për mënyrën e mbajtjes dhe evidentimit të shpenzimeve dhe të ardhurave dhe procedurat e kontaktimit të personelit të jashtëm dhe shërbimeve të tjera”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

ANEKS 1 FORMULARI I KËRKESËS PËR SHPENZIME PËR PASURINË

Kërkesa nr.				
Datë:				
	Emërtimi i pasurisë	Statusi	Nr. index	Nr. i kartelës
Nr.	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Shënime
1				
2				
Kostoja e pritur e shpenzimit (lekë)				
Llogaria nga do të kryhet shpenzimi				
Data kur kërkohet kryerja e shpenzimit				

Administratori i pasurisë
emri, mbiemri, firma)

Administratori i AAPSK-së
(emri, mbiemri, firma)

Miratohet
Kryeadministratori

ANEKS 2
KARTELA E PASURISË SË MBAJTJES SË SHPENZIMEVE DHE TË TË ARDHURAVE

Nr. i kartelës							
Subjekti		Emërtimi i pasurisë	Nr. index	Nr. i dosjes	Data e çeljes		
Nr.	Përshkrimi i veprimit	Data e veprimit	Shpenzime	Të ardhura	Gjendja		Kolona 3
					D	K	Llogaria e pasurive
	1	2	3	4	5	6	7
Shënime							
		Administrator i pasurive		Koordinator financiar			

